



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

---

Numri i lëndës: 2022:187273

Datë: 05.02.2024

Numri i dokumentit: 05286625

C.nr. 331/22

Gjykata Themelore Pejë-Dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Fllanza Hashani, me bashkëpunëtore Albulena Morina-Lulaj, në çështjen juridike-kontestimore të paditësit: M. (T.) K. , nga fshati P... , Komuna Klinë, kundër të paditurës: Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimi Rural AKP në Klinë të cilën e përfaqëson E. M. , sipas autorizimit në shkresat e lëndës, me bazë juridike: vërtetim i të drejtës së pronësisë nga e drejta e mbajtjes, vlera e kontestit: 4000€, gjatë shqyrtimit kryesor në prezencë të palëve ndërgjyqëse me datë 05.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET e tërhequr padia e paditëdit M. K. , kundër të paditurës Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural AKP-Klinë, me bazë juridike: vërtetim i të drejtës së pronësisë, vlera e kontestit: 4000€

A r s y e t i m

Paditësi në këtë gjykatë ka parashtruar padi me datë 13.09.2022, kundër të paditurës: Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural AKP-Klinë, me bazë juridike: vërtetim i të drejtës së pronësisë, vlera e kontestit: 4000€

Gjykata me datë 07.12.2023, ka caktuar dhe mbajtur seancën përgatitore ku prezent kanë qenë paditësi personalisht dhe përfaqësuesi i të paditurës E. M. .

Gjykata me datë 25.01.2024, ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor ku kanë prezantuar palët ndërgjyqëse, paditësi ka deklaruar se e tërheqi padinë ndaj të paditurës Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural-Klinë, meqenëse padinë e ka adresuar ndaj të paditurës e cila nuk ka të bëjë me këtë çështje.

Sipas nenit 261 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), përcaktohet se: *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”* dhe *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë.*

*Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh ng dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë”, andaj në referim të kësaj dispozite ligjore dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, rezulton se plotësohen të gjitha kushtet ligjore që padia në këtë çështje kontestimore, të konstatohet e tërhequr.*

Gjykata në bazë të nenit 261 lidhur me nenin 387 par. 1 pika c të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË-DEGA NË KLINË  
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil  
C.nr.331/22, datë 05.02.2024.

Gj y q t a r j a:  
Fillanza Hashani

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi.